

VENDIM
Nr.17, datë 8.6.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Hilmi Dakli,	Anëtar i	"	"
Hajredin Fuga	Anëtar i	"	"
Zija Vuçi	Anëtar i	"	"
Franc Jakova	Anëtar i	"	"
Kristofor Peçi	Anëtar i	"	"
Kujtim Puto	Anëtar i	"	"
Sokol Sadushi,	Anëtar i	"	"
Alfred Karamuço,	Anëtar i	"	"

me sekretare Drita Filto më datë 30.4.1998 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.12 Akti që i përket:

KËRKUES: Figali Bej e përfaqësuar nga avokatët Lili Robo e Viktor Konomi.

SUBJEKT I INTERESUAR: Frosina Zeqo përfaqësuar nga avokat Rolanda Dhamo.

OBJEKTI:

Deklarimi antikushtetues i vendimit nr.1387, datë 18.11.1997 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi shpjegimet e palës kërkuese, subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Në vitin 1952 është shtetëzuar në Tiranë një banesë, pronë e Milto Dushit, të cilën më pas shteti ua ka dhënë në pronësi, në formë kompensimi, vëllezërve Lalo. Deri në vitin 1994 kjo banesë ka qenë e ndarë në dy pjesë, njëra në pronësi të Thanas Lalos e tjetra të Frosina Zeqos dhuruar nga babai i saj në vitin 1972.

Me vendimin nr.326, datë 14.04.1994 Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të pronave, ka kthyer shtëpinë në tërësi në pronësi të trashëgimtarëve të Milto Dushit. Duke vlerësuar shtesat e bëra mbi këtë pronë të cilat zinin 14.4 % të vlerës së objektit në tërësi, komisioni vendosi që edhe shtesat të kalonin në pronësi të të lartpërmendurëve.

Frosina Zeqo, ka kundërshtuar në gjykatë vendimin e komisionit përse i përket pronësisë mbi njërin pjesë duke pretenduar se shtesat e bëra nga ajo zenë mbi 50 % të vlerës së objektit që ka pasur në pronësi.

Gjykata e Rrethit të Tiranës me vendimin nr.8867, datë 01.11.1996 ka vendosur që Frosina Zeqo të njihet si bashkëpronare me 53 % të vlerës së pjesës së banesës që e kishte pasur në pronësi para vitit 1994. Këtë vendim e ka lënë në fuqi Gjykata e Apelit me vendimin nr.175, datë 15.01.1997 si dhe kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit me vendimin nr.1387, datë 18.11.1997. Ankimi në këto gjykata është bërë nga Figali Bej, trashëgimtare e Milto Dushit, e cila ka marrë pjesë në procesin gjyqësor si person i tretë.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, Figali Bej pretendon se i janë cënuar të drejtat e saj si pronare nëpërmjet një procesi jo të rregullt ligjor, duke u shkelur kështu nenit 38 i Ligjit Kushtetues nr.7692, datë 31.03.1993 "Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut". Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, Figali Bej pretendon se i janë cënuar të drejtat e saj si pronare nëpërmjet një procesi jo të rregullt ligjor, duke u shkelur kështu nenit 38 i Ligjit Kushtetues nr.7692, datë 31.03.1993 "Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut". Për të mbështetur këtë pretendim, kërkuësia parashtrohet se përllogaritja e vlerës së shtesës është bërë e gabuar si përse i përket çmimeve të aplikuara ashtu dhe ndarjes në pjesë të pronës; se shtesat janë bërë në vitin 1992 pa leje ndërtimi.

Gjatë shqyrtimit të çështjes, Gjykata Kushtetuese konstaton se këto pretendime kanë të bëjnë me vlerësimin e konkluzioneve të ekspertëve të cilat sipas dispozitave procedurale civile përbëjnë provë e për pasojë vlerësohen si gjithë provat e tjera nga gjykata. Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkuësia në të gjitha shkallët e gjykimit nuk ka argumentuar ndonjë shkelje të parimeve esenciale për zhvillimin e rregullt të një procesi gjyqësor e për pasojë cënimin e të drejtës themelore të kërkuësës të parashikuar në nenin 38 të Ligjit Kushtetues nr.7692, datë 31.03.1993, gjë që mund t'i bënte këto vendime të cënueshme nga pikëpamja konstitucionale. Gjykata Kushtetuese, si organi më i lartë i kontrollit kushtetues nuk vlerëson provat në një proces gjyqësor e as i hyn shqyrtimit në themel të çështjeve konkrete, kompetenca këto ekskluzive të hallkave të sistemit gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 24 pika 9 e nenit 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me shumicë votash,

VENDOSI:

Prëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIM I PAKICËS

Jam kundër vendimit për këto arsye:

1. Sepse në rastin konkret jemi para zbatimit jo të drejtë të ligjit që cenon të drejtën e pronësisë së ankueses të parashikuar nga nenet 11 e 27 të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

2. Sepse Komisioni i Kthimit të Pronave i ka kthyer trashgimtarëve të Milto Dushit shtëpinë në tërësi, si një të vetme. Ligji "Për kthimin e pronave ish-pronarëve" ka dalë për të favorizuar ish-pronarët që u ishin shtetëzuar shtëpitë pa të drejtë. Pra një ligj që duhet interpretuar në favor të ish-pronarëve që u privuan padrejtësisht për 40 e ca vjet si mund të interpretohet në dëm të tyre?

3. Derisa kthimi u bë si shtëpi e vetme ish-trashgimtarëve të Milto Dushit, edhe shtesat duhen llogaritur në vështirësi të vlefshme të tërësisë së shtëpisë si një e vetme. Kështu me të drejtë e ka vlerësuar Komisioni i Kthimit të Pronave si pronë e vetme. Duke u pranuar teza e kundërt, siç ka vendosur Gjykata, atëherë do të ndodhte të privoheshin nga e drejta e pronësisë të gjithë ish-pronarët, pronat e të cilëve gjatë shtetëzimit do të kishin pësuar shtesa o anekse anësore si në rastin konkret.

Është e drejtë dhe ligjore të kompesohet ai që ka bërë shtesën me leje, por kjo të llogaritet kundrejt shtëpisë si një e vetme e jo në pjesë.

4. Vetë udhëzimi i nxjerrë për zbatimin ligjit "Për kthimin e Kompesimin e Pronave" parashikon që shtesat e bëra pa leje nuk merren parasysh në lidhje me kompensimin e shpenzimeve përkatëse.

Edhe kjo nuk është pasur parasysh.

ANËTAR
Hilmi Dakli